

Ne fokus/ Shtyhet derbi kryeqytetit

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 28 Shtator 2013 15:17



Derbi i shumëpritur mes Partizanit dhe Tiranës do të luhet një javë më vonë. Shkaku për këtë shtim të datës është bërë kërkesa e FSHF-së për të ruajtur tapetin e gjelbër pasi në datën 11 tetor, Shqipëria luan ndeshjen e fundit të eliminatoreve në shtëpi ndaj Zvicrës. Partizani dhe Tirana janë bezdisur nga ky ndryshim por nuk kanë se çfarë të bëjnë tjetër veçse të pranojnë verdiktin e kalendarit të ndryshuar nga FSHF. Derbi do të luhet në datën 13 tetor, në orën 20:00.